ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-23-5145-2-1-1/1**

Sa i përket tenderit për: **Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica- Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bregu i Diellit, Qendra Tregtare, nr. 42.,
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 999 007
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Ismajl Baftijari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com
(Adresa elektronike)

17.10.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

INSTITUTI SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË "INSI" shpk. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë – 24.05.2023
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 23.06.2023, 13:30h
Procesverbali i hapjes së tenderëve – 23.06.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK – anulimin e aktivitetit të prokurimit – 28.09.2023
Kërkesa për Rishqyrtim nga Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K. – 02.10.2023
Vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim nga AK – 12.10.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	x	

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				**Jo**		

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K., më 02.10.2023 ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës, duke prezantuar argumentet ligjore që si Operator Ekonomik pjesëmarrës nuk jemi pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" SH.P.K., nën arsyetimin se eksperti i propozuar për Master të Juridikut nuk ka dorëzuar diplomë të nostrifikuar, dhe se eksperti i propozuar për Master të shkencave shoqërore biologji-drejtimi i ambientit nuk ka paraqitur kontratat e punës për vitet paraprake, **kërkesa këto të cilat nuk kanë qenë të kërkuar në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.**

Në Kërkesën për Rishqyrtim INSI ka ofruar argumente ligjore që mbështesin konstatimet tona se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" SH.P.K., dhe se ne si OE ofertues jemi të përgjegjshëm, jemi OE më i lirë dhe i plotësojmë të gjitha kriteret e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues si në njoftimin për kontratë/dosje të tenderit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk merret fare me argumentet tona ligjore dhe padrejtësisht e refuzon kërkesën e parashtruar mbi disa argumente të reja e që janë krejtësisht të ndryshme nga arsyeja e eliminimit tonë nga gara.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" SH.P.K., parashtron Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40.6 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik
Neni 40.12 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik
Neni 43.5 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës më 28.09.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK/Letër standarde për tenderuesin e eliminuar për aktivitetin e prokurimit **Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica-Ritender**, me numër të prokurimit **616-23-5145-2-1-1/1**, me të cilën INSI-n e ka eliminuar nën arsyetimin se nuk i kemi përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht dy nga ekspertët e propozuar nga INSI nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar konform DT-së dhe Njoftimit për Kontratë, me ç'rast edhe ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit.

INSI pas publikimit të Vendimit të AK, më 02.10.2023 ka përgatitur dhe dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues, ndërsa AK më 12.10.2023 ka ngarkuar në E-prokurimi Vendimin mbi refuzimin e kërkesës.

INSI pas analizimit të tërësishëm të dokumenteve relevante, arsyes së eliminimit tonë si OE si dhe arsyes së refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, konsideron se Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prishtinës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me vendimin për eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K., përkatësisht anulimit në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit.

Sipas AK, arsyeja pse është refuzuar tenderi ynë, përkatësisht jemi eliminuar është si vijon
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:
Ju si OE-ik nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar konform DT-së dhe njoftimit për Kontratë për kërkesën: Master të Juridikut minimum 3 vite përvoja pune pas diplomimit. Ju si OE-ik për këtë kërkesë nuk keni dorëzuar Diplomën e nostrifikuar për personin të cilin e keni paraqitur për këtë pikë të kërkesës. Poashtu edhe për kërkesën tjetër: Master i shkencave shoqërore biologji-drejtimi i ambientit ju keni paraqitur dokumentacionin për bashkëpunëtorin tuaj por nuk keni paraqitur dëshmi sipas kërkesës Kontrata e punës për vitet paraprake (mungojnë dëshmitë e referencave), andaj për këto arsyeje jeni eliminuar.

INSI vlerëson se eliminimi ynë nga ky aktivitet i prokurimit nën arsyet e dhëna nga AK është i paqëndrueshëm dhe i kundërligjshëm, për faktin se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga AK si në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, dhe atë:

1. Për ekspertin e propozuar për Master të Juridikut, AK në Njoftimin për Kontratë/Dosje të Tenderit ka paraqitur këto kërkesa: **Master i juridikut, minimum 3 vite pervoje pune pas diplomimit – dëshmia e kërkuar dokumentare: CV-ja, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt,** dokumente këto të cilat janë dorëzuar të gjitha nga INSI.

Provë: Të bashkëngjitur gjeni dokumentet e dorëzuara për Master të Juridikut

2. Për ekspertin e propozuar për Master të Shkencave Shoqërore biologji – drejtimi i

Ambientit, AK në Njoftimin për Kontratë/Dosje të Tenderit ka paraqitur këto kërkesa: **Master i shkencave shoqerore biologji-drejtimi i ambientit ,minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit - dëshmia e kërkuar dokumentare: CV-ja, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt**, dokumente këto të cilat janë dorëzuar të gjitha nga INSI.

Provë: Të bashkëngjitur gjeni dokumentet e dorëzuara për Master të Shkencave Shoqërore Biologji – drejtimi i Ambientit.

INSI vlerëson se vendimi i AK për refuzimin e tenderit përkatësisht eliminimin tonë si OE ofertues nën arsyetimin e dhënë është në kundërshtim të plotë me **nenin 40.12 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik,** sipas të cilës: ***"Tenderuesi nuk do të diskulaifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri <u>që nuk është specifikuar</u> në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit."***

Provë: Kërkesa në Njoftimin për Kontratë/Dosje të Tenderit për ekspertët e propozuar

2.OE-ik duhet te ofroj deshmi per stafin profesional dhe ate si vijon; - Menaxheri i projektit -Inxhinier i ndërtimtarise ose arkitektures, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, - Inxhinier i arkitektures, minimum 3 vite pervoje pune pas diplomimit, - Master i juridikut, minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit, - Master i arkitektures, minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit, -Inxhinier ose master i ndertimtarise, minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit, -Inxhinier i komunikacionit, minimum 3 vite pervoje pune , -Master i shkencave shoqerore biologji-drejtimi i ambientit ,minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit, -Master i ekonomise ,minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit.

2.CV-ja, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Sipas kësaj kërkese në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nënkuptohet se nuk ka qenë kërkesë e AK që diploma të jetë e nostrifikuar, apo që eksperti i propozuar i shkencave shoqërore biologji-drejtimi i ambientit të paraqes dëshmi të referencave për përvojën e punës për vitet paraprake.

Andaj, INSI konsideron se AK me rastin e eliminimit përkatësisht anulim të aktivitetit në tërësi ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së dhe atë të **nenit 59, paragrafi 4 i LPP-së**, sepse oferta e dorëzuar nga INSI është në përputhshmëri të plotë me të gjitha

kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, **nenin 62 të LPP-së, përkatësisht nenit 43.5 të Rregullores nr.001/2022 të Prokurimit Publik**, sepse INSI ka dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe në përputhshmëri të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, **nenin 69 të LPP-së,** pasi që INSI i ka dorëzuar dokumentet e nevojshme që dëshmojnë kualifikimet e kërkuara dhe të specifikuara si në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, si **dhe nenin 72 të LPP-së,** sipas të cilës nëse AK ka konsideruar se dokumentet e dorëzuara nga INSI nuk janë të plota apo mungojnë dokumente specifike (siç ka pretenduar në rastin e ekspertit të propozuar të shkencave shoqërore-drejtimi biologji) ka mundur që të njëjtat ti kërkoj me kërkesë për informacione shtesë, meqë një kërkesë e tillë nuk ka qenë e kërkuar në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.

Për më shumë, pas pranimit të Vendimit mbi shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim nga AK, INSI gjen se arsyetimi i dhënë për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim dhe arsyes së eliminimit tonë nga gara, përkatësisht anulimit të aktivitetit të prokurimit, janë krejtësisht të ndryshme nga njëra – tjetra, dhe që të dyja të pabazuara dhe të kundërligjshme.
Në arsyetimin e vendimit të kërkesës për rishqyrtim, AK nuk është marrë fare me pretendimet tona të parashtruara në kërkesë, mirëpo ka gjetur diçka të re e krejtësisht të pabazuar, ku pretendon se ne nuk kemi dorëzuar fare diplomë të studimeve master për master të juridikut dhe të njejtën e cilëson si çertifikatë, si dhe konsideron se ne nuk e kemi kontestuar këtë fakt në kërkesën për rishqyrtim, ani pse një gjë e tillë nuk është përmendur fare në arsyetimin e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit, e INSI nuk ka pasur si ta kontestoj këtë argument të paqëndrueshëm.
Prandaj, INSI konfirmon se eksperti i propozuar për Master të Juridikut, z. Adil Bytyqi, ka përfunduar studimet e nivelit master pranë Universitetit të Maastrichtit.
Provë: Diploma e studimeve master

Maastricht University

Certificate

Having successfully completed the prescribed courses of studies for the Advanced Master Programme Intellectual Property Law and Knowlegde Management, the Faculty of Law on behalf of Maastricht University hereby awards the degree of

Master of Laws (LL.M.) to

Adil Bytyqi

Born

24 September 1985

in

Niksic Sjeverna

Maastricht, The Netherlands

31 October 2013

Dean of the Faculty

Director of Studies

Having successfully completed the prescribed courses of studies for the Advanced Master Programme Intellectual Property Law and Knowlegde Management, the Faculty of Law on behalf of Maastricht University hereby awards the degree of

Master of Laws (LL.M.) to

Adil Bytyqi

Për më shumë, eksperti i propozuar për Master të Juridikut e ka diplomën edhe të nostrifikuar, por meqë një kërkesë e tillë nuk është specifikuar në njoftimin për

kontratë/dosjen e tenderit, e njejtja nuk është bashkëngjitur.

Provë: Nostrifikimi i diplomës të ekspertit për Master të Juridikut

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Prishtinë, më 21/12/2015
Ref. Nr: 6/1174

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 5 paragrafi 4, nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, dhe nenit 16 paragrafi 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, *(Gazeta Zyrtare nr. 14/9 shtator 2011)*, nenit 17 paragrafët 5 dhe 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. *(22.03.2011)*, Udhëzimit administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës *(nr. 08/2010)*, dhe kërkesës nr. 6/4-3875, të datës 22.10.2015, së z. Adil Bytyqi, Këshilli Kombëtar për Njohje, nxjerr:

VENDIM

1. Z. Adil Bytyqi i njihet grada **"Master of Laws (LL.M.)"**, studime një vjeçare, e fituar në **"Maastricht University".**
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga ju, Këshilli Kombëtar për Njohje vendosi që të njihet grada e fituar në **"Maastricht University" në Holandë,** ashtu siç është e precizuar në dokumentin e lëshuar nga ky institucion: **"Master i Drejtësisë (LLM)".** Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga kandidati dhe nga informacionet e marra nga institucionet përkatëse nga vendi ku janë kryer studimet, Këshilli Kombëtar për Njohje vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi i dërgohet:
1. Palës;
2. Komisionit;
3. Qendrës NARIC;
4. Arkivit në MASHT.

Këshilla Juridike: Pala e pa kënaqur me vendimin ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa në MASHT në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

Drita Kadriu
Kryesuese e Këshillit Kombëtar për Njohje

Alush Istogu
u.d. i Sekretarit të Përgjithshëm

Duke u bazuar në faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Instituti për Shkencë dhe Teknologji "INSI" SH.P.K., është i bindur se ka dorëzuar tender të përgjegjshëm sepse tenderi ynë i përmbush të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues, dhe është në pajtim me LPP dhe e përmbush në tërësi nenin 40.6 të Rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik:

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në dosje të tenderit;
c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Po ashtu, AK nuk ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, pasiqë edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat si në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit, nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e paraqitur në emër të Operatorit Ekonomik Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" SH.P.K.

ANULOHET vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica-Ritender".

OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës që lëndën ta kthej në Rivlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, kërkesën për rishqyrtim, ankesë, si dhe fitim të munguar në vlerë prej 200.000.00 Euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

NJOFTIM PËR KONTRATË

Retender

☐ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☒ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 23.05.2023

Nr i Prokurimit	**616-23-5145-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**		
Adresa Postare: **TREPQES NR.2**		
Qyteti: **PRISHTINË**	Kodi postar: **-**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Visar Shehu**		Telefoni: **038 230 900**
Email: **prokurimi.prishtine@rks-gov.net**		Faksi: **n/a**
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: **https://kk.rks-gov.net/prishtine/**		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

;

& , 1

& , & , 1) < < 0 *)) * # < " ≪ 6 = -		
& , & $ 1 ; <) 0 <) = * 6 > 6 < 33 " " , - " $! . / $ 0 " 1 $ 1 . +		
*	* 3 "	0 / "
') 0) , # %) 0) 1 # 0 .2 % . .))	# $ - + # $ #)) ")	
& % / % % %) % /0 4) 4 # 0 < 6 =		
& , & % 1 ! " ! 0) " #)) 0		
& , & . 1 ! " =" 6 0) 3, $ + 2 " #)) 0 " #)) %0) 3) * ") # 4 , % 4 5 6)) - 0 3) * / <)) "3* #		
& , & (1 0) " 0<) *) < " ≪ 6 = - - ! * 0) "		

& , & + 1 < !) 0 0 ") * " 2 1 #

8 % ' ' ' ' ' ' - 7

& , & ? 1 0

& , & 7 1

% % % 0 , $ +

/

& , & 8 1 ! " = < 0 * + " $ +

7	'	,))

* " ") " < 6 @ " * 0 / < 0) * 0 #

& , & , ' 1 < 0) * . ' ') > ' ' ' & ' ' #

& $ 1

! * 0 6 " 0 0 " , .$ $ " $ $
! * 0) " = " "

& % 1 A B

0 + % +)% 3

(# #
, %

C ; B > > C

& , 1 ;

& , & , 1 *)) *) 3) * "

. / #) 0) ' 1 , ' 8 / #)

& , & $ 1 " < @ " " 6*) ") = <
) , $ +

& , & % 1 * 0 6 E ")= < /) 3) * ")

)) / / 2

& $ 1

& $ & , 1) 0 0 "	3 $ " 2
, &) ") * 0 ")) = !) * ; + ( ) * " * / <) 2 ; 1 > ; & ; " * 0)) 0 0) & 6 &	, &) ") * 0 " / * 0)) = !) * ;) * " * / 2 ;) 1 ; > ' . ; - . $ & ; " * 0)) 0) &) - 6 & , &) < / ") ") " / * 0)) " / 0 0 " + (& ' . ; - >. $ < ") & $ $ &6 " " " 6 0) ") >) ! < *) 0 " 6 " " 6) * " * ! * 6 3 " & 6 ") ") @ 0 / < ") 0 3 0 *) * * / <) ! " " / " *) * & % & 6 " B 4) @ 6 &) ") > * > " F 0 0 6 6 0 0 < * 4)) ") 4 6 < 0 / &) ") *) 0 ! < " " " " 0 * 0 4 @ &) 2 1 0 2 < 6 ") ") @ 3 0 0 / < ") 3 0 *) * * / <) " ! " " / " *) * & ") ") @ 0 3 * @ ") < <) * ")) *) > $ %0 *) * @ ! ! * 3 >) * " = = *) * < !) " * 0 " 8 8 & $; - 6 3 0 " 0 / < ") ") ") @ 0 < * 6 4 &
& $ & $ 1 0 0 " !	3 < $# " 2
, & ") ") ! < >) 0 = < " 6 6 0 " < "	, & = !) / 3

& $ & % 1 =) ") 0 3 $ = # " 2 , &	, &
& $ & . 1 =)) 0 3 $ < # " 2 , &) ") * 0 !) ! * * " *)) 6 < " " < + ' ' > ' ' ' * ! * *) ! < < * * / <)) ! < ") &	, & <) 6 < 3 * > * < *) ?) * * 0) *) * < < > 0 * " > ! < < "0 ! * " 0 ! * > 0 / 0) ! = = !) 4 0 / " 6 &
$ & -) * 0 ! 0 " ! < 0 6 G -) - F 0 ")) * > " " * " (6 6 < " " > F 0)) * > " " * " % 6 6 * < *) * > " " * " % 6 * < " " > -) " " * " % 6 6 * * < " " > F 0 " " > " " * " % 6 * < " " > - F 0) " * " " * " % 6 6 * > 0) = 6 0 @ / < - " / > " " * " % 6 6 * * < " " >) " > " " * " 6 6 * * < " "	$ & C - > < " >) " * * 0 " 6 " / 0 3 0 ")) &

& % 1 C H

& % & , 1) 3) * " 0 / " 6 3 6 * =) * ! - # . # % 0 % /)
& % & $ < * 0 ") * < !) " 6 ! < <) 3) * " 0 / " 6

C

& , 1 ; ; C

& , & , 1 ; < = *
0 *
) * ! 3 *
) * * " =
* " I " "
& , & $ 1 * ! 3 " * " 6 ! 0 < " , 1 " . / 1 + " 0 #) - / . 9) % % % 0 %

%)) 7 9) % % #)
0 % . % % " # / #) - /)) % % %/
) 0 %) #) - - % % 7
) - # %) 6) 0

& , & % 1 *) *'" 6 = 6 , 1 "
1 +

% ! - 0

! 0 / # % / -

)) % " #
) " 0 % / # # -

& , & . * "" " <) 6 = < ! 0 @ 3
! < < 0

& , & (& ! " < 0 ") <))

: %) % #)),

* # %) % #))

& $ 1

I " " " * <

) ") 0 " ! 6 0 " "

)	! =
, , & C " " " * < 6 < 0 + ' J	' & + '
$ $ & ! ! * ") 8"' & 6 < 0 . ' J ! ! * ") " F & , 7 ' 6 < 0 ' J	' & . '

& % 1 C

& % & , 1 * / <) ") < 0')

)

, " #) + $ + 2

:)

! 2 ' 1
% %

& % & $ 1 ! * " !

$ % & ' + & $ ' $ % " , % # % ' # ' ' " * 0 >> "
< ! " <)) -) * " &

& % & % 1) 0 3 " 0 0) *

!

& % & . 1 / %

. / # % + ' ' '
& # % , $ ' %

& % & (1 6 < 0 ! 0 " #
: % % 8 '

& % & + 1) 0 6 #

$ % & ' + & $ ' $ %) 0 , % # % ' # ' ' 6 " * 0 > > "
< ! " <)) -) * " &

C ;

& , 1

| < * " *) *) * > / 3
, ' 7 : ; & ' . : ; - ' . $ * " * / <) * / <) 6 >
0 < * " < & ' . : ; - $ % ? > < & ' (: ; - ' + 7 0 <
= !) *) ! ") &

& $ 1 C

0 " #) ")) 3) >
" 0) * " 6 0 " = <* < 0) 4
) 6) * " * 0 / 0 @ 3 &
$. 1 2 , . 1 . $! /+

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	616-23-5145-2-1-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica- Ritender
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
23.06.2023	23.06.2023, 13:30:00	23.06.2023, 13:30:00	Komuna e Prishtines,Departamenti i Prokurimit , permes platformes elektronike te E-prokurimit.	2

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Iusi SH.P.K., BREGU I DIELLIT - QENDRA TREGTARE LOK.NR.42, 10000, PRISHTINË	2306	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica-Ritender	PO	143220.33	169000.00	JO
2.	" GM Architecture " SH.P.K., Rr. Isa Kastrati Obj.49-K4 Nr. 41, 10000, Prishine	MPLK23	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica-Ritender	PO	157204.00	185500.00	JO

*[Ne rast se kriteri i shpërblimit të kontratës është **Çmimi me i ulët**] [If the contract award criterion is **the lowest price**] [Ako je kriterijum za dodelu ugovora **Najniža cena**]*
[ÇMIMET PËR NJËSI, *kurdo që është e mundur varësisht prej numrit te tendereve te dorëzuar, pozicioneve/artikujve, dhe pjesëve/loteve. Kjo te vendoset nga AK*
[The unit prices, whenever possible depending on the number of tenders submitted, items / articles, and parts / lots. The CA decides]
[CENE PO JEDINICI, *uvek kada je moguće u zavisnosti od broja podnetih tendera, pozicija/artikala, i delova/lotova. Ovo će odlučiti UA.*

Tenderuesi Tenderer Ponuđač	Pjesa Lot Deo	[Çmimi për Njësi] [Unit Price] [Cena po jedinici]							
		Art. 1	Art. 2	Art. 3	Art. 4	Art. 5	Art. 6	Art. n	Art. n+1
1	1								
	2								
	n								
2	1								
	2								
	n								
3	1								
	2								
	n								

[shto ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet Tenderi ekonomikisht me i favorshëm]
[Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if most economically advantageous tender]
[dodaj ili izbriši redove po potrebi u ovoj tabeli. Izbriši celu tabelu ako se primenjuje ekonomski najpovoljniji tender]

*[Ne rast se kriteri i shpërblimit të kontratës është **Tenderi ekonomikisht me i favorshëm**] [If the contract award criterion is **most economically advantageous tender**] [Ako je kriterijum za dodelu ugovora **Ekonomski najpovoljniji tender**]*

Tenderuesi Tenderer Ponuđač	Pjesa Lot Deo	Afati i liferimit në ditë Delivery time Datum isporuke	Garancioni Guarantee Garancija	Etj Etc itd.	Etj Etc itd.	Etj Etc itd.
1	1					
	2					
	3					
2	1					
	2					
	3					
3	1					
	2					
	3					

[shto ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet tenderi me çmimin me të ulët]
[Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if lowest price tender]
[dodaj ili izbriši po potrebi u ovoj tabeli. Izbriši celu tabelu ako se primenjuje tender sa najnižom cenom]

Komente nga përfaqësuesit e pranishem
Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:
Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda

_____
_____
_____
_____

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Shqipe Isufi		23.06.2023
Albina H Bajrami		23.06.2023
Shehide Jashari		
Flamur Sallahu		

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Albina H Bajrami

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI" Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

VENDIM

I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI" Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1.

II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-5145-2-1-1/1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim: *"Sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nënkuptohet se nuk ka qenë kërkesë e AK që diploma të jetë e nostrifikuar, apo që eksperti i propozuar i shkencave shoqërore biologji-drejtimi i ambientit të paraqes dëshmi të referencave për përvojën e punës për vitet paraprake. Andaj, AK me rastin e eliminimit përkatësisht anulimin të aktivitetit në tërësi ka bërë shkelje të dispozitave të LPP".*

Fillimisht duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën bëhet fjalë është lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të formuluar si në vijim:

2.OE-ik duhet te ofroj deshmi per stafin profesional dhe ate si vijon: **- Master i juridikut, minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit.** **-Master i shkencave shoqerore biologji-drejtimi i ambientit ,minimum 3 vite pervoje pune pune pas diplomimit.**	**2.CV-ja, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**

Përmes administrimit të dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur që sa i përket kërkesës për master të juridikut, parashtruesi nuk ka dorëzuar fare diplomën e studimeve master mirëpo në vend të kësaj ka dorëzuar në lloj të një çertifikate për përfundimin e një trajnimi/programi që nuk është as i licencuar dhe as i akredituar në Republikën e Kosovës. Ky fakt nuk është fare kontestues as për vet parashtruesin pasi që në pretendimin ankimor parashtruesi nuk e konteston të kundërtën mirëpo aludon se autoriteti kontraktues ka mundur të kërkoj sqarime shtesë. Megjithatë në rastin konkret komisioni vlerësues ka gjetur se nuk bëhet fjalë fare për diplomë të studimeve master sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit prandaj nuk ka pasur hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë. Në këtë formë është gjetur se i njëjti nuk e përmbushë këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Ngjashëm edhe sa i përket kërkesës për master të biologjisë, komisioni vlerësues ka gjetur se parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për përvojën e punës që sipas DT është kërkuar 3 vite pas diplomimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

CV

1. **Pozita e propozuar:** Jurist

2. **Emri**: Adil Bytyqi

3. **Kompania**: Instituti për Shkencë dhe Teknologji "INSI" SH.P.K.

4. **Data e lindjes**: 24.09.1975 **Nacionaliteti**: Shqiptarë

5. **Edukimi:**

Universiteti	**Titulli**	**Data**
Universiteti i Maastrichtit	MASTER NË TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE DHE MENAXHIM I NJOHURIVE (LL.M.)	2012 – 2013
Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik Universiteti i Gent	Jurist i Diplomuar SHKËMBIMI SI STUDENT MUSAFIR NË SHKENCA JURIDIKE DHE POLITIKE	2005 – 2009 2010 - 2011

Gjuha

Gjuha	**Lexim**	**Folur**	**Shkruar**
Shqip	Gjuhë amtare	Gjuhë amtare	Gjuhë amtare
Anglisht	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm
Holndeze	Mirë	Mirë	Mirë
Italisht	Mirë	Mirë	Mirë

Eksperiencat e punës:

Gusht 2022 – Prezent

Punëdhënësi: **Shoqëria – BOGA & ASSOCIATES, Prishtinë Kosovë**
Pozita: **Ekspert Ligjor**
Opinionet juridike për klientët kryesisht investitorë të huaj dhe kompani që bëjnë biznes në Kosovë; Lehtësimi i krijimit të biznesit dhe procedurave për investitorët e huaj, duke përfshirë por

pa u kufizuar në punonjësit e tyre; Ndihma e bizneseve vendore për çështje ligjore dhe çështje të tjera përkatëse; Dhënia e mendimeve lidhur me legjislacionin e Kosovës, plotësimi i pyetësorëve dhe menaxhimi i projekteve për organizatat rajonale dhe ndërkombëtare; Hartimi i kontratave, letrave paralajmëruese, padive, ankesave, propozimeve përmbarimore dhe akteve të tjera ligjore në emër të klientëve të zyrës sonë ligjore; Detyra të tjera përkatëse

---

Janar 2019 – Gusht 2022

Punëdhënësi: **SEKRETARIATI I KOORDINATIMIT QEVERITAR – ZYRA E KRYEMINISTRIT**
Pozita: **ZYRTAR I LARTË PËR KOORDIMIN E POLITIKAVE**
Koordinimi i punës së Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Tregtisë për zbatimin e aktiviteteve të tyre dhe hartimin e politikave dhe legjislacionit të ri; Ndihma e ministrive nën mbikëqyrjen time për hartimin e akteve ligjore dhe koncept dokumenteve dhe dhënien e opinioneve përfundimtare për procedurat e miratimit të Qeverisë; Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të e planit vjetor të punës së qeverisë dhe vendimeve të qeverisë; Siguria që të gjitha aktivitetet e reja dhe iniciativat ligjore të jenë në përputhje me politikat e qeverisë; Puna për uljen e barrës administrative për administratën, bizneset dhe qytetarët; Detyra dhe aktivitete të tjera përkatëse.

Gusht 2021 – Tetor 2021

Punëdhënësi: **INSTITUTI PËR QEVERISJE LOKALE TË KOSOVËS DHE DEMOS - DECENTRALIZIMI DHE MBËSHTETJA E KOMUNËS**
Pozita: **EKSPERT LIGJOR – ME KOHË TË PJESSHME**
Rishikimi i legjislacionit në fushën e qeverisjes vendore; Hartimi i ligjit të ri për ndryshimin e ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Nëntor 2015 – Shkurt 2020

Punëdhënësi: **BEK-ING SHPK**
Pozita: **KONSULENT ME KOHË TË PJESSHME PËR ÇËSHTJET JURIDIKE DHE ADMINISTRATIVE**

Hartimi i dokumenteve të brendshme administrative, si dhe kërkesave dhe ankesave të shoqërisë; Interpretimi i legjislacionit përkatës të Kosovës; Këshillimi për procedurat ligjore të institucioneve të Kosovës lidhur me kontratat me autoritetet komunale; ◦ Përgatitja e dokumenteve për aplikime për tender; Aktivitete të tjera.

Maj 2019 – Shtator 2019

2014 – 2016
Punëdhënësi: **INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE**
Pozita: **Trajner**
Ligjërata si trajner për zyrtarë të institucioneve të ndryshme publike se si të hartohen koncept dokumentet për politikat dhe legjislacionin e ri.

Shkurt 2017 – **Prill 2019**

Punëdhënësi: **YORK FASHION SH.P.K., Suharekë, Kosovë**
Pozita: **PRONAR/DREJTOR**
Tregtia me shumicë dhe pakicë e veshjeve dhe këpucëve të importuara nga Britania e Madhe dhe Polonia; Komunikimi me zyrën e furnitorit në Londër dhe porosia e rregullt e produkteve; Menaxhimi i kontratave dhe aktiviteteve të tjera të biznesit.

Korrik 2018 – **Dhjetor 2018**

Punëdhënësi: **MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE – CEFTA, Bruksel, Belgjikë**
Pozita: **EKSPERT DYTËSOR KOMBËTAR PËR TREGTIMIN E SHËRBIMEVE DHE INVESTIMEVE**
Menaxhimi i funksionimit të përditshëm të Nën-komitetit për Tregtinë e Shërbimeve dhe trupave të tij punues, d.m.th. Grupi i Përbashkët Punues për Tregtinë e Shërbimeve, statistikat FATS dhe IHD; duke ndjekur Grupin e Përbashkët të Punës për Investimet në Ballkanin Perëndimor (BP) në bashkëpunim me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR), si dhe Mobilitetin e Profesionistëve në Ballkanin Perëndimor (Negociatat për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, nën kujdesin e KBR); Monitorimi i progresit në liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor; Identifikimi, rishikimi dhe propozimi i masave për barrierat në tregtinë e shërbimeve ndërmjet palëve të CEFTA-s; ◦ Vendosni kontakte dhe përditësoni rrjetet ekzistuese në administratat kombëtare të çdo vendi të CEFTA-s. ◦ Bashkëpunimi me strukturat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare me synim thellimin e bashkëpunimit rajonal në investime dhe tregti në

shërbime (përkatësisht BE, OBT, RCC, GIZ, OECD, UNCTAD, etj.); Kontributi në tenderimin e projekteve për ekzekutimin e asistencës teknike të synuar.

Dhjetor 2014 – **Korrik 2018**

Punëdhënësi: **MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË**
Pozita: **ZYRTAR I LARTË LIGJOR PËR MARRËVESHJE TREGTARE DHE ÇËSHTJE TJERA JURIDIKE -**
Pjesëmarrja në negociatat për tregtinë e mallrave dhe shërbimeve brenda vendeve të CEFTA-s dhe Njohja e Kualifikimeve Profesionale në rajon, nën kujdesin e KBR; Zbatimi dhe zbatimi i akteve ligjore tregtare dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në; Hartimi i legjislacionit dhe politikave të reja; Aktivitetet lidhur me tregtinë e shërbimeve, antidumping, konkurrencën dhe mbrojtjen e tregut; Rishikimi i Marrëveshjeve Tregtare të Kosovës; Adresimi i barrierave të sektorit privat në tregtinë me shtetet tjera dhe të bërit biznes në Kosovë; Interpretimi i legjislacionit kombëtar; Hulumtimi i tregut dhe promovimi i eksportit; Çështjet e OBT-së dhe organizatave të tjera rajonale; Kryesues i Komisionit të Ankesave të Ministrisë për Kërkesat dhe Ankesat e bizneseve kundër Vendimeve të Agjencisë për të Drejtat e Pronësisë Industriale (DPI).

Shtator 2017 – **Nëntor 2017**

Punëdhënësi: **Ministria Italiane e Zhvillimit Ekonomik - Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Tregtare Ndërkombëtare, Romë Itali**
Poizta: **SHOQËRIA - ZYRTAR I LARTË I QEVERISË**
Pjesëmarrja në takime me diplomatë të ndryshëm të huaj dhe përfaqësues të tregtisë; Hartimi i raporteve të takimeve me diplomatë dhe përfaqësues të ndryshëm për përgatitjen e komiteteve të përbashkëta me vendet e tjera; Analizimi i dokumenteve për pozicionet e komiteteve të përbashkëta dypalëshe; Vizita e shumë institucioneve përkatëse për të marrë praktikat e tyre më të mira si Zyra Italiane e Pronësisë Intelektuale, Divizioni i OBT-së dhe institucione të tjera të lidhura me tregtinë.

Prill 2015 – **Janar 2016**

Punëdhënësi: **KËSHILLI BRITANIK, EYCA KOSOVO DHE KOLEGJI UNIVERSUM**
Pozita: **PËRKTHYES**
Përkthimi i tekstit shkollor "E drejta ndërkombëtare" nga autori Malcolm D. Evans nga anglishtja në shqip si pjesë e projektit të përbashkët i zbatuar nga Kolegji Universum, Këshilli Britanik dhe EYCA Kosovë

Prill 2015 – **Janar 2016**

Punëdhënësi: **MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË - AGJENCIA E PRONËSISË INDUSTRIALE TË KOSOVËS**
Pozita: **ZYRTAR I LARTË LIGJOR PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**
Hartimi i legjislacionit të ri në fushën e të drejtave të pronësisë industriale; Puna në dokumentet e politikave kombëtare në lidhje me IPR-të; Ekzaminimi i markave tregtare, patentave dhe aplikacioneve për dizajn industrial; Përgatitja e publikimeve (doracakë, broshura, buletin) për të drejtat e pronësisë industriale; Promovimi i të drejtave të pronësisë intelektuale; Interpretimi i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar; Anëtar i Komisionit të Ankesave të Ministrisë për Kërkesat dhe Ankesat e bizneseve kundër Vendimeve të Agjencisë për DPI.

Publikimet:

- Manual për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.
- Bashkautor "15 Years of Transition in Kosovo Trade".

Trajnimet dhe Edukimi:

Qershor 2022

PROVIMI I JURISPRUDENCËS SË KOSOVËS - Ministria e Drejtësisë

Korrik 2016 – **Nëntor 2016**

Zhvillimi dhe Udhëheqja e Politikës Publike - **Certifikata e Përfundimit** - USAID dhe Universiteti Amerikan në Kosovë.

Janar 2016 – **Shkurt 2016**

